



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA SHQETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA	
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA	
ZYRA E ARKIVIT - KANCELARIJA ARHIVA - ARCHIVE OFFICE	
Niveli i Çështjes	Nr. Prot. 02
Pr. No.	Pr. No.
Data 15.02.2012	Date
No. pages	Date
PRISHTINË/A	



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. 11/02

Datë: 15.02.2012

Në mbështetje të nenit 3 paragrafi 2, 3, 4, 5 dhe nenit 49 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Mbikëqyrësit e Agjencisë morën:

V E N D I M

1. Urdhërohet operatori i telefonisë mobile Vala të bëjë asgjësimin e të gjitha kopjeve fizike dhe elektronike të dokumenteve të depozituara me rastin e verifikimi të të dhënave personale.
2. Asgjësimi i tyre duhet të bëhet deri më 15. 04. 2012
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Gjatë inspektimit është konstatuar që operatori i telefonisë mobile Vala gjatë regjistrimit të abonentëve depoziton kopje të dokumenteve personale, andaj siç është specifikuar në nenin 3 pika 2, 3, 4, dhe 5 të Ligjit 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale, depozitimi i këtyre të dhënave e ka tejkalar qëllimin për të cilin përpunohen. Pas kontrollit të datës 13.02.2012 në operatorin mobil Vala për mbikëqyrjen e zbatimit të vendimit Nr. 02/12 të datës 22.12.2011, është konstatuar se operatori i telefonisë mobile Vala i duhet kohë shtesë për të asgjësuar të gjitha kopjet fizike dhe elektronike të dokumenteve të depozituara me rastin e verifikimit të të dhënave personale.

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Mbikëqyrës Shtetëror
Državni Nadzornik



Mentor Hoxhaj

Mentor Hoxhaj

Bekim Demjri

Bekim Demjri

Saksandar Spasic

Saksandar Spasic

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Operatorit të telefonisë mobile Vala
- Arkivit të Agjencisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA SHQETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA	
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA	
ZYRA E ARKIVIT-KANCELARIA ARCHIVA-ARCHIVE OFFICE	
Nr. Prot. (Prot. No):	01
Nr. Prot. (Prot. No):	126
Nr. i faqëve (Noj stranica):	01
Data (Datum):	22.12.2011
PRISHTINEJA	



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. 01/11

Datë: 22.12.2011

Në mbështetje të nenit 49 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Mbikëqyrësit e Agjencisë morën:

V E N D I M

1. Urdhërohet operatori i telefonisë mobile Vala që të ndërmerë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e dosjeve fizike të abonentëve në harmoni me nenin 14. pika 1.1 të ligjit 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Afati për eliminimin e parregullsive është 8 ditë pune.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit të vendimit.

Arsyetim

Gjatë inspektimit të hapësirës ku janë të arkivuara/depozituara dosjet fizike të operatorit të telefonisë mobile Vala është konstatuar që masat e sigurisë janë nën nivelin e duhur, pra nuk i plotësojnë kushtet e parapara në nenin 14.1 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Mbikëqyrës Shtetëror
Državni Nadzornik

Mentor Hoxhaj

Bekim Demiri

Aleksandar Spasic

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Operatorit të telefonisë mobile Vala
- Arkivit të Agjencisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA
ZRYA E ARKIVIT-KANCELARIA ARHIVA-ARCHIVE OFFICE

Nr. Prot. 127
Br. Prot. 127
Prot. No:

Nr. i ftoqevje 37
Data 22.12.11
Dokument

PRISHTINË/A



Nr. 02/12

Datë: 22.12.2011

Në mbështetje të nenit 3 paragrafi 2, 3, 4, 5 dhe nenit 49 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Mbikëqyrësit e Agjencisë morën:

V E N D I M

1. Urdhërohet operatori i telefonisë mobile Vala të bëjë asgjësimin e të gjitha kopjeve fizike dhe elektronike të dokumenteve të depozituara me rastin e verifikimi të të dhënave personale.
2. Të asgjësohen dokumentet e abonentëve të cilët nuk janë aktiv dhe të cilët i kanë kryer detyrimet apo pasi t'i ketë përmbyllur procedurat gjyqësore.
3. Asgjësimi i tyre duhet të bëhet deri më 15. 02. 2012
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Gjatë inspektimit është konstatuar që operatori i telefonisë mobile Vala gjatë regjistrimit të abonentëve depoziton kopje të dokumenteve personale, andaj siç është specifikuar në nenin 3 pika 2, 3, 4, dhe 5 të Ligjit 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale, depozitimi i këtyre të dhënave e ka tejkaluar qëllimin për të cilin përpunohen.

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Mbikëqyrës Shtetëror
Državni Nadzornik

Mentor Hoxhaj

Bekim Demiri

Aleksandar Spasic



Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Operatorit të telefonisë mobile Vala
- Arkivit të Agjencisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA	
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA	
ZYRA E ARKIVIT-KANCELARIJA ARHIVA-ARCHIVE OFFICE	
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	128
Nr. i Ekipave Hivi KRAJICA	Data Datum 22.12.2011

Nr. 03/11
Datë: 22.12.2011

Në mbështetje të nenit 3 paragrafi 2, 4 dhe 5 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Mbikëqyrësit e Agjencisë morën:

V E N D I M

1. Urdhërohet operatori i telefonisë mobile Vala që pas verifikim të nevojshëm të të dhënave të deklaruar gjatë regjistrimit të mos ndalin/mbajnë fotokopje të asnjë dokumenti në të cilin ka të dhëna personale.
2. Afati për ndalimin e depozitimit fillon nga data 01. 01. 2012.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Gjatë inspektimi të operatorit të telefonisë mobile Vala e kemi vërtetuar se operatori në fjalë depoziton fotokopje të dokumenteve personale të abonentëve, depozitimi i të cilave është në kundërshtim me nenin 3 paragrafi 2, 4 dhe 5 të Ligjit 03/L-172. Operatori mund të kërkojë dokumentet e nevojshme për verifikim për të arritur qëllimin e saj, por pas verifikimit çdo depozitim i fotokopjeve të dokumenteve të cilat mbajnë të dhëna personale është kundërligjore, ngase depozitimi i këtyre të dhënave tejkalon qëllimin për të cilin përpunohen.

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Mbikëqyrës Shtetëror
Državni Nadzornik

Mentor Hoxhaj

Bekim Demiri

Adem Spasic

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Operatorit të telefonisë mobile Vala
- Arkivit të Agjencisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA SHETETERORE PER MBROJTJEN E TE DHENAVE PERSONALE	
DRZAVNA AGENCIJA ZA ZASTITU LICNIH PODATAKA	
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA	
ZYRA E ARKIVIT-KANCELARIAJIA ARHIVA-ARCHIVE OFFICE	
Nr. Prot. 01	Nr. Prot. 129
Hr. Prot. 01	Hr. Prot. 129
Data: 22.12.2011	
Datum: 22.12.2011	
PRISHTINE/A	



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. 10/11

Datë: 22.12.2011

Në bazë të nenit 38 të Ligjit 03/L-172, për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Mbikëqyrësit e Agjencisë morën:

V E N D I M

1. Këshillojmë operatorin Vala që ti përbushin obligimet/detyrimet që dalin nga neni 16 pika 2 të Ligjit 13/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Çdo përpunues i të dhënave duhet të përshkruajë në aktet e brendshme procedurat dhe masat e vendosura për sigurinë e të dhënave personale dhe duhet të emërojë në formë të shkruar personat kompetent që janë përgjegjës për sistemimin e dosjeve dhe personat të cilët, për shkak të natyrës së punës së tyre, duhet të përpunojnë të dhënat personale

Arsyetim

Gjatë inspektimit të operatorit të telefonisë Vala, në vendin ku janë të arkivuara/depozituara dosjet fizike, kemi kërkuar rregulloren e brendshme për procedurën e qasjes në të dhënat e depozituara dhe autorizimet për personat përgjegjës që kanë qasje në këto të dhëna. Përfaqësuesit e operatorit vala ka dështuar të na prezantojnë rregulloren e brendshme për qasje në këto të dhëna dhe autorizimet e personave përgjegjës.

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Mbikëqyrës Shtetëror
Državni Nadzornik



Mentor Hoxhaj

Bekim Demiri

Aleksandar Spasic

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Operatorit të telefonisë mobile Vala
- Arkivit të Agjencisë